



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 89

Prishtinë, më 8.10.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR dhe MMPH.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 1.10.2012,
3. Takimi me zyrtar të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë rreth çështjeve mjedisore dhe bujqësore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 1.10.2012.

3. Shqyrtimi i gjendjes në mjedis dhe në bujqësi bashkërisht me zyrtar të dy ministrave përkatëse

Kryetari i Komisionit falënderoi për pjesëmarrjen e dy ministrave : **Dardan Gashi dhe Blerand Stavileci** të cilët gjithashtu falënderuan për bashkëpunim. Fillimisht ministri i bujqësisë z. Stavileci filloi me një pasqyrë të shkurtër për periudhën e kërkuar nga komisioni nga aspekti legjislativ dhe ashtu me radhë. Ai potencoi faktin se kjo ministri punon në bazë të dokumentit strategjik bazë Plani i zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural me të cilin parashihet AVUK të kthehet në MB, pyjet të menaxhohen ashtu si është më së miri (personalisht nuk kundërshtoi që të menaxhohen nga një ministri, edhe poçes është fjala për MMPH, por potencoi se është mendim personal i tij). Përparimet dhe problemet në këtë ministri, vazhdoi, janë po aq sa ka pasur investime, çka mund të thuhet p.sh. për shërbimet këshilluese ngase investimet do të tregojnë patjetër rezultate pozitive, pastaj në sektorin e drithërave me subvencione të cilat sivjet priten të rriten ndoshta edhe për 50% me 4.5 milion për 6000 ha. Sidomos për këtë vit do të nevojiten investimet dhe donacionet kur dihet se çfarë thatësie ka dominuar, në ngritjen e serave të reja, investime kapitale, 53 ndërtime të pendëve, qendrat informative etj. Ai potencoi suksesin e arritur me Ambasadën Amerikane rreth fondit garantues për kredi bujqësore e cila do të jetë e realizuar pjesë pjesë dhe me faza me bankën qendrore. Siguri të lart do të ofroi sidomos regjistrimi i bujqësisë, potencoi, ngase do të ulë rrezikun e investimeve në kultura bujqësore duke siguruar sistemin e sigurimeve, efektet e punësimeve nga grantet dhe subvencionet (9 milion subvencione dhe 5 milion grante), fermerët do të përkrahen me sistemin 70 me 30, kështu që nuk do të mbetet asnjë sektor pa përkrahje. Sa i përket pyjeve ai theksoi se është punuar gjatë me disa donator dhe është hartuar Projektligji i dërguar në Kuvend, në ndërkohë është arrit marrëveshja me komuna që të hyrat të janë 50 me 50 me institucionet qendrore. Duke pa mosfunksionimin e disa niveleve menaxhuese, ai siguroi se me këtë projekt janë eliminuar pengesat në favor të mbrojtjes më të mirë të pyjeve.

Liburn Aliu nuk ndërhyri në çështjet e përgjithshme bujqësore (për të cilat poashtu ka mjaft çka të diskutohet) ngase si tha më aktuale në komision është Projektligji për pyje të cilin e kundërshtoi ngase kanë mbetur gjërat njësoj si është tani e dhjet vite, sidomos nga ana e strukturës.

Nijazi Idrizi lavdëroi punën e MB në çdo aspekt dhe apeloj tek dy ministrat prezent të bëjnë bashkërisht më tepër sa i përket ujërave gjeotermike dhe në përgjithësi për ujëra.

Salih Morina u fokusua për Ligjin e Këshillimeve sa po zbatohet në nivel lokal dhe sa është arritur me modernizimin e mjeteve bujqësore dhe a ka projekt për këtë.

Sevdije Lama pyeti për Ligjin e Komasionit, a ka pasur të interesuar për rregullim tokash si vullnetar (sidomos në rrethin e Gjakovës).

Ministri Stavileci u përgjigj që së shpejti rezultatet do të shihen sa i përket shërbimeve këshilluese në 23 komuna dhe do të vërtetohet se kjo punë është në të mirën e fermerëve, përndryshe ai sqaroi se shërbyesit këshillimor trajnohen me praktikatat më të mira për të ofruar këshilla fermerëve, ndërsa sa i përket mjeteve bujqësore ministri tha edhe po të rritet 500 euro për hektar, me këto pajisje të vjetruara shumë vështirë përparon bujqësia, ndërsa sa i përket komasionit vullnetar mori shembull komunën e Vitisë.

Nait Hasani sa i përket pyjeve tha se është kërkuar zgjedhja më e mirë e mundshme në komision por megjithatë është kërkuar nga Qeveria (shkresë e dërguar Kryeministrit) sugjerim si të mbetet tani e tutje menaxhimi me pyje, pastaj të rekomandohet Projektligji për leximin e parë. Si arsyetim kryesor i kryetarit ishte se pyjet shkatërrohen ndërsa përgjegjësia mbetet jetim, u bashkëngjiti edhe **Liburn Aliu** i cili potencoi se asgjë nuk ka ndryshuar me projektin e dërguar sa i përket strukturës së tanishme të menaxhimit. Reagoi **ministri** dhe sqaroi : menaxhimi është i APK ndërsa mbrojtja Komunitat, mirëpo prapë ndërhyri **Liburn Aliu** dhe konstatoi se shembulli i Deçanit, Prizrenit etj tregojnë se shkatërrimet sërish ndodhin në pyje sidomos me tendera, ai sugjeroi formulën : menaxhimi pa zyra regjionale dmth zyrat regjionale të kalojnë nëpër komuna ndërsa inspektorati të mbetet në nivelin qendror, edhe më konkretisht tha : pylltari është i

komunës, leja për prerje është e dyanshme (dy qeqiqa) –kjo assesi nuk bënë, parku me menaxhua kufinjt e vet por pa APK, në zonën 3 mund të ndërhyj shteti me stimulime për bujqësi por në aspektet tjera të zhvillimit të bujqësisë. Ai shkurt pyeti : çka konsideroni ju në ministri pyllin, a është diçka që zhvillon ekonominë apo mjedisin. **Ministri Stavileci** u përgjigj shkurt sipas formulës EDHE EDHE duke eliminuar OSE OSE, njëherit tha se vullneti është maksimal në ministrinë e bujqësisë për një marrëveshje të mirëfilltë dhe për një zgjidhje strukturore afatgjatë.

Nijazi Idrizi u pajtua se projektligji ka të meta dhe i përmendi disa mirëpo shtoi se vendbanimet në Kosovë janë mjaft të shpeshta përreth pyjeve për shkak të mbijetesës së popullatës nga produktet pyjore dhe se duhet të ndërpriten prerjet ilegale. Ai u pajtua pjesërisht me Liburnin se duhet të kemi prerje të planifikuara dhe shtoi se duhet të gjendet çmimi real për këtë popullatë (15-20 euro). **Liburn Aliu** : çka i bjen kjo (pyeti), dhe ritheksoi se formula më e mirë do të ishte mbrojtja të i takon komunave ndërsa inspektorati të jetë i centralizuar dmth prerje të pyjeve mund të ketë por jo prerje industriale (me tenderë).

Kryetari sugjeroi ende mos të dërgohet Projektligji në leximin e parë derisa të hiqen dilemat. **Ahmet Zejnullahu** arsyetoi projektligjin duke cekur se pyjet kërkojnë mbrojtje specifike, ndërsa për APK tha se roli i saj ka qenë monitorues, gjithashtu arsyetoi ekzistimin e zyrave regjionale ngase ato nuk bëjnë politikë por monitorojnë, në fund konstatoi se miratimi i dy Projektligjeve për parqe do të komplikoi gjendjen e pyjeve. **Kryetari** përmbylli diskutimin me Ministrin e Bujqësisë duke cekur nevojën për një takim të veçantë me dy ministrinë në Komision.

Dardan Gashi ministër, pasi që kryetari i Komisionit paraprakisht u fokusua në problemet aktuale në komision, sikurse ministri i bujqësisë pasqyroi aktivitetet në MMPH sa i përket legjislacionit, ndërsa sqaroi edhe për monitorimet që janë duke u zhvilluar duke përkrahur punën e komisionit që bënë lidhur me monitorimin e VNM, VSM, Ajrit dhe Zhurmës, ndërsa rreth shumës së kërkuar nga INKOS për matje tha se është duke u shqyrtuar në departamentin e buxhetit pranë ministrisë. Ai shtoi se procedimi i Projektligjeve në Kuvend është duke shkuar sipas planit si dhe hartimin e atyre që duhet të procedohen dhe i ceku disa përparime që janë bërë rreth menaxhimit me ajrin siç janë ndërrimi i filterëve në KEK, Feronikël, Sharrcem, sa i përket hartimit të ligjit për ndërtimet ilegale dhe planifikimit hapësinor, ligjin e fondit mjedisor (për të cilin kërkoj mbështetjen nga deputetët). Lidhur me pyjet tha se në MMPH nuk ka dilema se ato duhet të kalojnë nën menaxhimin e Parkut Kombëtar, ndërsa si metodë balancimi theksoi se Qeveria mund të ndërmarr një hap me të cilin rregullon çështjen e Agjencisë së komplekseve memoriale, AVUK dhe APK-MMPH. **Nait Hasani** pyeti sa po zbatohet Ligji për QHP (Prizrenin) dhe hapja e zyrës, për të cilin ministri tha se kanë kërkuar fond shtesë për vitin 2013 për këto dy komuna (Prizrenin dhe Hoçën) përndryshe mbeten Ligje të pa zbatuara, gjithashtu u përgjigj se Ligji për ndërtimet pa leje nuk përfshinë zonat e veçanta përkatësisht këto dy komuna. Kryetari sugjeroi të insistohet në rregullimin e këtyre problemeve përmes një shkrese që do të dërgohet. **Salih Morina** apeloi te zyrtarët e MMPH sidomos tek ministri që mos të dërgojnë Projektligje në Kuvend pa mbulesë financiare, për çka u pajtuan edhe zyrtarët e MMPH duke potencuar se në mungesë të buxhetit atyre ju duhet të kërkojnë donacione dhe sidomos duhet të miratohet Ligji për fondin mjedisor. **Daut Haradinaj** pyeti për buxhetin e sivjetmë a do të përcillet në vitin e ardhshëm bashkë me obligime si dhe a ka buxhet për Agjencinë për memoriale për vitin vijues, përgjigja ishte se të gjitha obligimet përfshihen edhe në vitin vijues ndërsa shuma është 4.5 milion euro. Rreth pyetjes së parashtruar për ZRRUM tani ZRRUK zyrtarët e MMPH konstatuan se ajo duhet të mbetet e pavarur sa i përket tarifave, ndërsa licencimet të mbeten në kompetencë të MMPH (gjatë vizitës së delegacionit të Komisionit në Shqipëri, zyrtarët atje nuk u pajtuan që licencimet ti marr ministria por duhet ti takojnë kësaj zyreje). **Ahmet Zejnullahu** potencoi faktin sa është relevant shkresa e dorëzuar nga Asociacioni Kombëtarë i pronarëve të pyjeve private të Kosovës, e cila nuk ka nënshkrim.

Gjatë mbledhjes së Komisionit dy ministrat prematuan se do të dërgojnë komisionit me shkrim të dhënat që u cekën para Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani